

K O N K U R S

Institucioni Privat i Arsimit Parauniversitar, **Horizon School Kosova SH.P.K**, licencuar nga MASHTI me numër licence 3-1214, bazuar në Ligjin Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar, Ligjin Nr. 03/L-212 të Punës, si dhe Statutin e shkollës, shpallë konkurs për plotësimin e vendit të lirë të punës, për vitin shkollor 2025/2026, si vijon:

- **Mësimdhënës për lëndën e Gjuhës Shqipe.....(1)**

1. ***Kualifikimet e nevojshme:***

Kandidatët duhet të kenë të përfunduar shkollimin përkatës universitar sipas Ligjit për Arsimin Parauniversitar:

- ***Fakulteti i Filologjisë***

Drejtimi: Gjuhë Shqipe dhe Letërsi Shqipe

Kualifikime tjera:

- Përvoja relevante profesionale;
- Trajnime dhe certifikime sipas standardeve;
- Përparësi kanë mësimdhënësit me Trajnimin e Kurrikulës të përfunduar;
- Njohuri adekuate kompjuterike;

Aftësi:

- Aftësi të larta pedagogjike;
- Aftësi të shkëlqyera të komunikimit dhe prezantimit;
- Shkallë të lartë të vetiniciativës;
- Aftësi të bashkëpunimit në grup.

2. ***Mënyra e aplikimit***

Kandidatet e interesuara duhet të dërgojnë dokumentet e kërkuara më poshtë në emailin info@horizonschool-ks.com.

- CV-në;
- Diplomat universitare;
- Trajnime dhe certifikime;
- Dokument identifikimi;
- Dokumente tjera përcjellëse.

3. ***Shënim: Aplikimet kanë filluar dhe konkursi mbetet i hapur deri më datë 26/10/2025***